



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PA1.nr.1/2021

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me sekretaren juridike Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.D. nga Gjilani, për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit se të akuzuarit B.D. av.Mustaf Nuhju, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr 990/2019 të datës 01.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 24.03.2021 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar, ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit B.D. av.Mustaf Nuhju, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.990/2019, të dt.01.12.2020, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.990/2019, të dt.01.12.2020, është shpallur fajtorë i akuzuari, B.D. për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par 1 i KPRK-së, dhe i është shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është obliguar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën i njëjti i shndërrohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 25 ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzet) euro, në kuptim të nenit 43 par.3 të KPRK-së.

Është Obliguar i akuzuari B.D., që pronën e uzurpuar ta liroj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata në kuptim të nenit 463 par 2, të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike i ka udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko civil.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësorë në shumën prej nga 50 (pesëdhjetë) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të kimit shumën prej

nga 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor, ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit B.D. av.Mustafë Nuhiu, për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të KPP-së, dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe shpenzimeve të procedurës penale, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga fajësia, pasi që nuk është provuar që ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, ose që e njëjta të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.24/2021, të datës 01.03.2021, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit B.D. av.Mustafë Nuhiu, të refuzohet si e pabazuar kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

#### **Ankesa e mbrojtësit se të akuzuarit B.D. av.Mustafë Nuhiu, nuk është e bazuar**

Përkundër, asaj që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar të njëjtin sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhë në përfundim se i njëjti nuk përfshihet në shkeljet esenciale nga neni 384 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten si në dispozitivin e aktgjykimit, ngase përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare, të cilat e karakterizojnë veprën penale uzurpimi i pa ligjshëm i pronës së paluajtshme, në kuptim të nenit 320 par.1 të KPK. Gjithashtu, kolegji ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kuptim të nenit 370 të KPPK, ngase aktgjykimin e ka përpiluar konformë përmbajtjes dhe formës së paraparë në dispozitën përkatëse ligjore, si dhe ka paraqitur arsye për çdo pikë të aktgjykimit dhe ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuar, si dhe ka vlerësuar saktësinë e secilës provë, e cila është me rëndësi për zgjedhjen e çështjes juridiko penale.

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit B.D., av.Mustafë Nuhiu, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar edhe për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, sepse vendimin e ka mbështetur në deklaratën e të dëmtuarit A. K., si dhe dëshmitarëve S. M., A. R., S. K. dhe R. S.. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar se pronë e kujt ka qenë parcela e uzurpuar, përkatësisht bodrumi, sepse me asnjë dokument nuk vërtetohet që i dëmtuari A. K., është pronar i parcelës, kurse referuar ligjit nr.03/L-154, për pronësi dhe të drejtat e tjera sendore, paluajtshmeria duhet regjistruar në regjistrin e të drejtave në paligjshmëri – zonën kadastrale. Është evidente që pronar i bodrumit, në sipërfaqen prej 59,88m<sup>2</sup>, është B.D., dhe se i njëjti vet ka pranuar se nuk është pronar i sipërfaqes prej 3-4m<sup>2</sup>, i bodrumit, mirëpo, këtë thekson se e ka uzurpuar me pëlqimin e banorëve të tjerë dhe se e ka shfrytëzuar si

pjesë përbërëse të bodrumit të vet. Gjithashtu, nga asnjë provë nuk ka mundur që të vërtetohet se pronar të sipërfaqes 3-4<sup>m2</sup>, janë A. K., apo dëshmitarët e lartpërmendur, ashtu që këtu i akuzuari vazhdimisht ka deklaruar se e ka bërë uzurpimin e 3-4<sup>m2</sup>, me qëllimin më të mirë, që të mirëmbaj të njëjtin, ngase nëpër ato 3-4<sup>m2</sup>, kanë kaluar gypat e kanalizimit dhe se kur e ka marrë bodrumin për ta shfrytëzuar për nevoja të veta, i njëjti ka qenë i mbushur me ujë si dhe mbeturina, dhe ka bërë investime të konsiderueshme që të njëjtin ta kthejë në gjendje të shfrytëzueshme duke i futur si pjesë të përgjithshme edhe 3-4<sup>m2</sup>, përkundër asaj që nuk ka pasur dokumentacion se kjo sipërfaqe është e tija.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje juridiko penale, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse i akuzuari B.D., nuk ka qenë i parcelës 3-4<sup>m2</sup>, por nuk kanë qenë as i dëmtuari A.K., dëshmitarët S.I., A.R., R.S. e S.K.. Se nga kjo lëndë ekziston një marrëveshje e lidhur në mes të B.D.t dhe A.K., për shfrytëzimin e bodrumit me dt.06.07.2017, ekziston në shkresat e lendes, mirëpo vet A.K. ka deklaruar se nuk është pronar i kësaj parcelës sikurse nuk janë edhe dëshmitarët e lart përkthuar. Vet i akuzuari B.D., ka pranuar se e ka shfrytëzuar sipërfaqen e cila është objekt i akuzës, përkundër asaj që nuk ka pasur ndonjë dokumentacion përcjellës, duke theksuar se fillimisht kur e ka marrë në shfrytëzim, e ka bashkuar së bashku me bodrumin e tij, të cilin e ka pastruar sepse ka qenë i mbushur me ujë si dhe mbeturina e gjithashtu pasi që kanë kaluar gypat e kanalizimit nëpër sipërfaqen kontestuese edhe të njëjtën e ka bërë pjesë përbërëse të bodrumit të vet, pasi që i ka rregulluar edhe gypat e kanalizimit, si dhe ka bërë investime tjera të duhura për ta mirëmbajtur në gjendjen e duhur të njëjtën. Të gjitha këto janë vërtetuar nga deklarata e dëshmitarëve të lartë theksuar, kurse deklarata e dëshmitares R.S., pasi që e njëjta nuk ka mundur që të jetë prezentë në seancën gjyqësore, është lexuar ajo e dhënë në polici me dt.12.09.2019, janë lexuar edhe fleta poseduese dhe kontrata për shitblerjen e pronës e motorizuar me nr.OPR.BR07100/2017, me numër të referencës 0162/2017, e dt.08.02.2017, kontrata e dt.12.02.1992, aktvendimi i dt.14.11.2019, aktvendimi i dt.22.12.2018, identifikimi – regjistrimi i pjesëve të ndërtesave i dt.16.10.2019, identifikim - regjistrimi i pjesëve të ndërtesave i dt.20.03.2017, aktvendimi i dt.21.06.2018, vërejtja e dt.17.10.2003, kontrata e shitblerjes e S.P., si dhe fotografitë nga vendi i ngjarjes. Gjithashtu, kolegji i kësaj gjykate pasi që ka vlerësuar provat personale, në kuadër të tyre ka vlerësuar edhe deklaratën e të akuzuarit B.D., i cili ka pranuar se e ka marrë në shfrytëzim sipërfaqen 3-4<sup>m2</sup>, ka pasur ndonjë dokumentacion që e vërteton pronësinë, që rezulton se e njëjta nuk ka qenë as në pronësi të dëshmitarëve – dëmtuarve A.K. dhe dëshmitarëve të tjerë, të cilët janë theksuar më lartë. Po ashtu edhe nga provat materiale rezulton se në këtë çështje penale i akuzuari nuk ka pasur dokumentacion përcjellës për ta vërtetuar se është pranuar i sipërfaqes kontestuese, andaj, kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që i ka vërtetuar të gjitha fakte të cilat e karakterizojnë çështjen penale, dhe me të drejtë ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale uzurpimi i pa ligjshëm i pronës së pa luajtshme nga neni 320 par.1 të KPK dhe e ka shpallur fajtor duke i shqiptuar dënimin përkatës ligjor.

Mbrojtësi i të akuzuarit, me ankesën e ushtruar e ka ankimuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të shkeljeve të ligjit penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, përkitazi me provat për përcaktimin e

fajësisë nga neni 262 të KPPK, dhe se i njëjti vetëm një prove i ka kushtuar besim, kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar ankesën e ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, pasi që ka vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale uzurpimi i pa ligjshëm i pronës së pa luajtshme nga neni 320 apr.1 të KPK, drejtë ka vendosur kur e ka zbatuar ligjin e aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, se nuk ka gjetur arsye që të akuzuarin ta përjashtoj nga ndjekja penale, si dhe përgjegjësia penale dhe se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, që rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Mbrojtësi i të kuzuarit aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ankimuar edhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe shpenzimeve të procedurës penale, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje penale, kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor, nuk e ka zbatuar parimin “indubio pro reo”, të paraparë në nenin 3 par.2 të KPPK, ngase mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal, interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij, sipas këtij kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nga se asnjë provë kredibile nuk ka ekzistuar që i akuzuari të shpallet fajtor, kurse në vlerësim të deklaratës së të akuzuarit, i njëjti rezulton se nuk e ka pranuar fajësinë përkitazi për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është vërtetuar me administrimin e provave nga ana e gjykatës për veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, sikurse janë rrethanat lehtësuese, si dhe ato rënduese ashtu që ka pasur parasysh dispozitën ligjore nga neni 69, dhe si rrethanë lehtësuese ka pasur parasysh se i akuzuari ka bashkëpunuar me institucionet duke iu përgjigjur ftesave të gjykatës për pjesëmarrje në gjykatë, po ashtu ka pasur parasysh se i akuzuari asnjëherë tjetër nuk ka ra në kundërshtim me ligjin, i martuar, baba i tre fëmijëve, se është mbajtës i familjes, e gjithashtu ka pasur parasysh si rrethanë rënduese mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallen e intensitetit të kryerjes së të njëjtës. Gjithashtu, kolegji ka vlerësuar se në këtë çështje penale janë respektuar të gjitha parimet të cilat e karakterizojnë procedurën penale, nga ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit, B.D., av. Mustafë Nuhiu, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj, në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1/2021, të datës 24.03.2021**

**Sekretarja juridike,  
Fitnete Hoti**

**Anëtarët e kolegjit  
Hashim Çollaku**

**Zyhdi Haziri**

**Kryetari i kolegjit  
Ferit Osmani**